

**SPIRO GJONI**

**NJË VËSHTRIM ORIGINAL I SË KALUARËS SË POPULLIT TONË  
(ROMANI “NOMEJA E LARGËT” I F. BALLANCËS)**

Pas leximit të tregimeve, novelave dhe reportazheve të Faik Ballancës, natyrisht krijon një opinion të përgjithshëm dhe, për rrjedhojë, edhe një vlerësim të caktuar, jo vetëm për autorin por dhe për veprën e tij letrare. Por, ky opinion dhe vlerësim nuk mund të merren si të plotë dhe të saktë, kur dimë që Faik Ballanca ka botuar edhe një roman. Në ç’masë kjo vepër i shton vlerat e krijimtarisë letrare të këtij autori, ç’vend zë në kuadrin e gjithë veprës së Ballancës, cila është e reja që kjo vepër sjell, krahasuar jo vetëm me krijimtarinë e plotë të tij, por në një plan më të gjerë, me krijimtarinë letrare të kohës ku jetoi e krijoi autori - këto pyetje dhe të tjera që kanë ngacmuar vëmendjen tonë, kërkojnë përgjigje, por edhe një argumentim i cili përbën në fund të fundit synimin tonë, në kuadrin e qasjes dhe vlerësimit tërësor të veprës letrare të Faik Ballancës.

Që në takimin e parë me romanin e Ballancës pra, që me leximin e titullit të tij (paksa të çuditshëm) dhe, më pas, me njohjen e subjektit dhe strukturës kompozicionale të kësaj vepre, e kupton se ke përpara një roman disi të veçantë, jo vetëm nga përmbajtja por dhe nga realizimi artistik. Pyetjeve që parashtruar më lart, do t’u shtonim dhe dy të tjera të cilat janë pjesë e kureshtjes që shoqëron lexuesin gjatë gjithë leximit të romanit:

- Çfarë e ka shtyrë autorin drejt mjediseve dhe njerëzve që lëvizin ngjarjeve të këtij romani?

- Përse Ballanca ka vënë në qendër të veprës së tij jetën e barinjve dhe banorëve të një fshati, mbase jo të humbur, por të vogël, diku në jug të Shqipërisë?

Përgjigjen, për të shuar këtë kureshtje, e gjen duke lexuar një krijim pararendës të romanit, novelën “Katër orë larg shtëpisë”, botuar prej autorit në vitin 1972, pra, shumë kohë më parë se të dilte në dritë romani i tij. Këtu, na duhet të hapim një parantezë për të vënë në dukje se Ballanca dhe historia e krijimtarisë së tij, kanë një specifikë të veçantë që do të thotë se, jo në të gjitha rastet, dalja në dritë e një krijimi apo libri të tij (në rastin konkret e romanit “Nomeja e largët”) përputhet me dëshirën apo mundësitë që ai ka.

Ekziston një e vërtetë e rëndësishme në këtë mes e cila lidhet me faktin se, dëshira e shkrimtarit për të shkruar një roman, lindi pas botimit të novelës që përmendëm më sipër. Nuk qenë vetëm ngjarjet e novelës ato që ofronin mundësinë për ta zgjeruar veprën, me synim kthimin e saj në roman,

por dhe dëshira e guximi krijues i vetë autorit për të provuar aftësitë e tij në fushën e prozës së gjatë.

\* \* \*

Pyetjet, që renditëm më sipër, në thelb nuk lidhen me historikun e lindjes apo krijimit të romanit “Nomeja e largët”. Përkundrazi, ato më shumë na shtojnë drejt kërkimit dhe zbulimit të shkaqeve dhe motiveve që e çuan autorin drejt një subjekti të veçantë, si në rastin e novelës, ashtu dhe në procesin e shndërrimit të saj në roman.

Në qoftë se romani, në aspektin tipologjik apo kronologjik, është për autorin pasardhës i novelës “Katër orë larg shtëpisë”, vetë novela në kuadrin e projekteve krijuese të Ballancës, është rrjedhojë e natyrshme e mbresave të veçanta nga udhëtimet e tij si gazetar.

Jo vetëm nga dëshmitë e vetë shkrimtarit, por dhe nga shënimet e pohimet e miqve, kolegëve apo dhe studiuesve të veprës së tij dhe, në mënyrë të veçantë mikut të tij, poetit Pandeli Koçi, mësojmë se subjekti i novelës mori jetë nga një udhëtim i shkrimtarit (shërbim pune dhe, njëkohësisht, plotësim i një ftese të përsëritur të Pandeliut për një vizitë në vendlindjen e këtij të fundit), në zonën e Rrëzës, dhe saktësisht, në fshatin Lekël.

Pikërisht këtu ngjizet ideja e një shkrimi, jo thjesht reportazh por një novelë e cila, siç e vumë në dukje dhe më lart, me kohë evoluoi, duke u shndërruar në një roman. Rreth dy vjet pas botimit të novelës, Faiku përfundon dhe dorëzon në konkursin letrar me rastin e 30 Vjetorit të Çlirimit të Atdheut, romanin “Nomeja e largët”.

Për fatin e keq të autorit, por jo të romanit, historia e kësaj vepre, këtu na ofron një moment aspak të këndshëm. Përsëri, sipas dëshmive dhe fakteve të vërtetuara edhe zyrtarisht, kjo vepër iu kthye shkrimtarit dy herë si e pabotueshme..?!

Mendojmë se është me interes t’u referohemi përgjigjeve që i erdhën autorit nga redaksia e romanit në Lidhjen e Shkrimtarëve, si edhe arsyeve ku mbështeteshin anëtarët e redaksisë e pretendimeve që rendisnin, për refuzimin e romanit. Në përgjigjen e parë, ndër të tjera, shokët e redaksisë e lidhnin shqetësimin kryesor me një ndër personazhet e rëndësishëm të veprës, Bendon.

Sipas tyre, “Ai nuk përfaqëson atë të huaj (dukuri - shënim im, S.Gj) kundër së cilës vërtet ne luftojmë, sepse ajo penetron dhe përpiqet të penetrojë në mënyrat më të ndryshme, në ideologjinë dhe në jetën tonë, në përgjithësi. Në këtë drejtim Bendua është krejt i kundërt. Të huaj të tillë asimilohen nga populli midis të cilit jetojnë. Po kryesorja është se lexuesi nuk bindet që

Bendua është i huaj.. Autori nuk e ka individualizur si figurën e një të huaji mbetur në Shqipëri, po si një njeri që ka pësuar një shok nga lufta...”<sup>1</sup>

Ka dhe vërejtje e qëndrime të tjera, por vërejtja që, për mendimin tonë, duket si më e pasakta është ajo sipas së cilës, “Romani... është më tepër një grupim tregimesh, ai s’ka linja të tilla që të kenë për bazë një konflikt themelor sipas të cilit do të zhvilloheshin figurat kryesore apo personazhet episodikë. Prandaj romani tingullon fragmentar e duket si i montuar.”<sup>2</sup>

Fakti që Faiku debutonte për herë të parë (jo në letërsi) me llojin e romanit, në një kohë kur romani shqiptar kishte arritur nivele të larta dhe ishte prodhim i penave, tashmë me emër në fushën e letrave, por dhe kultura e tij, e bënin Faikun tepër të vëmendshëm dhe të ndjeshëm ndaj vërejtjeve të kolegëve. Prandaj ai i mirëpriti vërejtjet dhe sugjerimet e shokëve apo anëtarëve të Redaksisë dhe njëkohësisht, me mirëkuptim, vullnet e këmbëngulje, iu fut punës dhe, brenda një kohe të shkurtër e paraqiti sërish romanin, të pasuruar dhe ripunuar në përbërësit e tij themelor. Por edhe Redaksia nuk ia vonoi shumë përgjigjen nga e cila ne do veçonim tre-katër rreshta që janë të mjaftueshëm për të zbuluar tendenciozitetin negativ të qëndrimit të saj.

“E shqyrtoam romanin tuaj dhe kemi mendimin se ka mbetur në përgjithësi në gjendjen e mëparshme. Mesa duket, ju nuk keni reflektuar në vërejtjet e Redaksisë<sup>3</sup>. Për të qenë më “seriozë” shokët e redaksisë nuk mjaftohen me kaq. Kritikojnë subjektin e romanit, “evidentojnë” një lloj eklektizmi të autorit në krijimin e personazhit të Bendos dhe në vazhdim, i tregojnë autorit “muskujt” nëpërmjet dy pyetjeve tepër tendencioze: “Ç’i intereson letërsisë sonë një figurë e tillë qendrore? (Është fjala për Bendon - shënim i imi, S.Gj).

Si mund të shpjegohet një farë mëshire kristiane që kanë disa barinj (ndaj tij - shënim i imi, S.Gj) kur dihet se Bendua ka ardhur si pushtues dhe, si i tillë, është i rrezikshëm për ne, pavarësisht se tani është i degraduar si njeri dhe në një gjendje thujtë psikopatie?”<sup>4</sup>

Gjithçka është e qartë, shokët e Redaksisë kërkonin skemën e gatshme, modelin në fuqi, zbatimin e metodës së socrealizmit. Për ta vepra e Ballancës kishte devijuar jo pak nga këto kërkesa dhe norma. Mungonte heroi i tyre pozitiv, por dhe ideja kryesore nuk qe tepër e qartë dhe e qëndrueshme.

<sup>1</sup> Nga procesverbali i mbledhjes së Redaksisë së romanit, Tiranë 1974.

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Nga procerverbali i mbledhjes së Redaksisë, Tiranë 1975.

<sup>4</sup> Po aty.

Krahas tendenciozitetit negativ, pyetje apo vërejtje të tilla i shohim si tepër të nxituara dhe të pambështetura me argumenta. Do të mjaftonte vetëm dalja nga kallupi i “Izmave” e kufizimeve të metodës dhe vlerësimi të realizohej mbështetur mbi një analizë objektive dhe kritere të caktuara artistike e shkencore, për të kuptuar menjëherë ndihmesën “pozitive” dhe “dashamirësinë” e Redaksisë. Një procedim i tillë do të nxirrte njëkohësisht në dritë edhe vlerat e vërteta të veprës që, sipas mendimit tonë, përfaqëson një roman “ndryshe”. Sigurisht, një përcaktim apriori, nuk mund të jetë i plotë dhe i saktë, pa u argumentuar dhe vërtetuar në të gjithë elementët përbërës të veprës: tema, struktura kompozicionale, ndërtimi i personazheve, gjuha, mjetet dhe mënyrat nëpërmjet të cilave shpreh dhe përcjell mesazhet, etj.

\* \* \*

Vepra e Ballancës nuk përfaqëson një roman “ndryshe” në kuadrin e krijimtarisë së tij pasi dihet që ai nuk ka shkruar romane të tjerë me të cilët ajo të krahasohej. Mendimi ynë shkon më tej dhe, në këtë kontekst romani i tij na rezulton një roman “ndryshe”. Madje veprën, nga kjo pikëpamje, do ta quanim, pa mëdyshje, risi apo gjetje origjinale, në kuadrin e prozës sonë të gjatë, jo vetëm për kohën kur u shkrua.

Do të qenë të mjaftueshme konsideratat që sjellin rreth kësaj vepre dy ndër emrat më në zë të letërsisë sonë, Ismail Kadare dhe Teodor Laço. “Ky ishte romani i tij i parë dhe çuditërisht se si ka mundur të realizojë një strukturë kompozicionale të tillë, sa të vështirë aq dhe moderne”<sup>5</sup>.

Kurse Laço shprehet se “... tregimtari i talentuar, që shquhej për finesën e gjetjeve e detajeve artistike, hynte në prozën e gjatë nga porta e saj e madhe.”<sup>6</sup>

Natyrisht dhe pena të tjera, shkrimtarë dhe kritikë thanë mendimin dhe vlerësimin e tyre për veprën (romanin) në tërësi apo elementë të tij në veçanti, duke vënë në dukje atë që e dallonte dhe shprehte origjinalitetin e saj. Në këtë kuadër është dhe përpjekja jonë, e cila sigurisht nuk pretendon të jetë shteruese.

Le të përpiqemi së pari të argumentojmë mendimin tonë në planin përmbajtësor. Ajo që spikat më shumë në këtë drejtim mendojmë se lidhet me lëndën e veçantë të cilën ka qëmtuar dhe shfrytëzuar autori; si lëndën me prejardhje historike ashtu dhe atë bashkëkohore. Këtu zbulohet qartë edhe aftësia e këtij shkrimtari në zgjedhjen e materialit jetësor. Ballanca, përgjithësisht, tenton drejt një materiali i cili, në thelb, nuk është thjesht një “lëndë e parë” që mundëson ndërtimin e një subjekti të caktuar, por shumë më

<sup>5</sup> I. Kadare, “Drita” 4 mars 2007, f. 4.

<sup>6</sup> T. Laço, “Drita” 19 gusht 1990, f. 6.

tepër, pasi synimi i autorit shkon përtej thurjes së një subjekti apo thjesht pasqyrimin të një ngjarjeje. Janë synimet ideore dhe artistike ato që “e ulin” shkrimtarin para tavolinës dhe e bëjnë atë të shkruajë e të rishkruajë, jo thjesht për të përcjellë një mesazh por edhe për të ofruar një vlerë të arrirë artistike.

Një lexues i vëmendshëm i romanit, qoftë dhe me një lexim të vetëm, do të dallonte të paktën tre elementë që janë pjesë e synimeve ideoartistike të Ballancës:

1. Autori ka tentuar dhe përzgjedhur një material të veçantë që, me pak përjashtime, është në funksion të idesë apo mesazhit që ai kërkon të përcjellë përmes veprës.

2. Është i dukshëm fakti që Ballanca, nëpërmjet përzgjedhjes së materialit nga dy periudha të ndryshme kohore dhe ndërthurjes së tyre në një mënyrë tejet origjinale, ia ka dalë të realizojë një unitet të spikatur ideor mes së shkuarës dhe realitetit bashkëkohës.

3. Në këtë proces përzgjedhës shkrimtari tregon një vëmendje të veçantë edhe për karakteret, që do të thotë se i gjithë materiali i përzgjedhur është në funksion të zbulimit të tyre.

Nuk paraqet aspak vështirësi lokalizimi i mjedisit ku ndodhin ngjarjet dhe nga ku është përzgjedhur lënda e parë për thurjen e subjektit të veprës. Gjithçka ndodh në një fshat të jugut, ku pjesa dërrmuese e banorëve merren me blegtori. Por kjo është vetëm njëra pamje e jetës së këtij fshati pasi Ballanca e ka zgjedhur këtë mjedis jetësor edhe për një arsye tjetër, jo pa rëndësi, që lidhet me faktin se fshati ka edhe një moment të veçantë në historinë e tij. Mbi këtë fshat dhe mbi shumë prej banorëve të tij (kryesisht të moshuar tashmë) kishin kaluar shumë luftëra, vuajtje e halle, kishin shkelur ushtri pushtuesish të ndryshëm, duke lënë pas shkatërrime, si në planin fizik ashtu dhe në atë social e psikologjik. Dëshmia më e mirë dhe më e pasur në këtë aspekt, të cilën autori e ka shfrytëzuar mjeshtërisht, është memorja historike e banorëve të fshatit, jeta, interesat dhe problemet e të cilëve janë në qendër të ngjarjeve që përbëjnë subjektin e këtij romani. Sigurisht interesimi dhe vëmendja e shkrimtarit shtrihet më tepër në kohë sesa në hapësirë, duke u përqendruar më shumë në jetën e një banori të veçantë i cili është dhe “nuk është” pjesë përbërëse e komunitetit fshatar. Ky banor, aq i veçantë, edhe pse jo protagonist i veprës në kuptimin parësor të këtij nocioni, është ish-ushtari i huaj, Bendo.

\* \* \*

Në vazhdim të idesë dhe përcaktimit tonë, do të shtonim se ky personazh është pjesë përbërëse e një të tërë, duke mos qenë ndërkohë pjesë reale e saj!! Duke thënë pjesë e së tërës nënkuptojmë se ai është një ndër aktorët e ngjarjeve që, në lidhjen e tyre me njëra-tjetrën, në zhvillimin dhe

ecurinë e tyre përbëjnë subjektin e romanit. por, nga ana tjetër, pohimi ynë se ai nuk është pjesë e së tërës, përsëri është i vërtetë pasi Bendua, nuk është vendas, nuk është banor autokton i atij fshati malor, edhe pse punon e jeton bashkë me një pjesë banorësh të tij. Ai është një ushtar i huaj, të cilit nuk ia mësojmë origjinën e vërtetë por që, një mangësi e tillë, nuk e pengon lexuesin në të kuptuarit dhe të vlerësuarit e këtij karakteri.

Herë mes saktësive dhe herë mes pasaktësive, të ofruara jo rastësisht nga shkrimtari, mësojmë për një ushtar të huaj (nga?!), të mbetur rob gjatë një beteje në jug të Shqipërisë (ku?, kur?) i cili ka humbur kujtesën (si?, pse?) dhe prej disa kohësh shtyn vitet e jetës së tij, duke punuar mes barinjve të fshatit Lug.

Vetë rrjedha e ngjarjeve ofron ndër të tjera mundësinë të njihesh me këtë “ushtar të huaj”, me këtë “rob lufte të padorëzuar”, këtë “njeri të panjohur”, që e rritën disa prindër, po ashtu “të panjohur”; të njihesh me të quajturin Bendo i cili e dinte dhe nuk e dinte pse dhe si gjendej në këtë fshat e mes këtyre barinjve dhe banorëve.

Ngatërruar nëpër labirintet e një figure të tillë, lexuesi, për një moment edhe mund të pozicionohet në krahun e anëtarëve kritizerë të Redaksisë së Lidhjes, duke u bashkuar me opinionin e tyre rreth çështjes: “Ç’i intereson letërsisë sonë një figurë e tillë qendrore?” Sigurisht, nisur nga kufizimet e letërsisë së realizmit socialist, romani i Ballancës në tërësi dhe personazhi i Bendos në veçanti mund të qenë objekt i një kritike më të ashpër ose mund të ishin orientuar “më natyrshëm” drejt skemave standarte të cilat do t’i shndërronin, pa asnjë dyshim: romanin në një vepër “dinjitoze” dhe Bendon në një hero pozitiv, tepër të dashur, ose në një armik të egër të klasës, popullit dhe atdheut. Nëse nuk ndodhi krejtësisht kështu, ajo që ndodhi, mund të themi se nuk kishte shumë ndryshim.

\* \* \*

Faktet, dëshmitë dhe të dhënat vërtetojnë se vepra dhe, jo pak, autori i saj, nuk i shpëtuan viktimizimit. Romani nuk e pa dritën e botimit sa që gjallë autori. Kjo ishte njëra anë e medaljes, ana absurde dhe e dhimbshme, ndërkohë që krejt ndryshe ishte ana tjetër e saj. Falë qëndrimit jo dashamirës dhe pengues, humbi, por më shumë fitoi autori dhe vepra e tij. Nëse qëndrimi intolerant i Ballancës ndaj elementeve thelbësorë të veprës, “dënoi” vetë atë, kjo autosakrificë e imponuar ndihmoi letërsinë dhe lexuesin tonë, duke iu dhuruar atyre e lënë trashëgim jo një shabllon a një vepër skematike, që shpejt do ta mbulonte pluhuri i harresës, por një vepër realiste, që bart vlera, jo vetëm për kohën që u shkrua, por dhe për të sotmen e të ardhmen, një vepër të atij niveli a lloji që na jep të drejtën ta veçojmë si një roman “ndryshe”.

Sigurisht këtë veçori, për ta argumentuar dhe bërë më bindëse, duhet ta kërkojmë edhe në elemente të tjerë të veprës. Një nga këta që, për nga përkatësia, është i formës, është kompozicioni. Përpjekjet për ta klasifikuar kompozicionin e kësaj vepre, në njërin apo tjetrin tip, hasin në vështirësi që në leximin e kapitujve të parë të romanit. Por, para se të shprehemi për tipin kompozicional të romanit, le të marrim shkurtimisht në konsideratë subjektin e tij, i cili ngrihet mbi një fabul të thjeshtë, ku spikat linja e jetës dhe punës së përditshme të ushtarit të huaj, Bendo.

Në këtë kuadër ia vlen të sjellim në vëmendjen tonë disa pjesë nga një intervistë e shkrimtarit, dhënë TV shqiptar më 1974 e botuar edhe në gazetën Drita.

“Në romanin tim të parë unë trajtoj temën e fshatit... Merrem më tepër me jetën e një kolektivi baritor, i cili jeton në malet e Labërisë. Mund të mendohet që jeta e barinjve nuk të jep dorë për të trajtuar gjerësisht tema shoqërore... Natyrisht, tema e fshatit, tema e barinjve që është temë e ditëve së sotme, është temë tepër e rëndësishme, por mua më ka interesuar, si në shumë tregime, alternimi i kësaj teme me motivet patriotike”<sup>7</sup>.

Duke veçuar fundin e citimit të mësipërm ku autori ve në dukje interesimin e tij për alternimin e temës së ditës me motive patriotike, duhet të theksojmë se, një dukuri e tillë, nuk ka munguar në letërsinë tonë. Veçse, ajo që spikat dhe është e re në këtë dukuri, lidhet me mënyrën origjinale të realizimit të këtij alternimi, një fakt tjetër ky që flet në favor të mendimit tonë për një roman “ndryshe”.

\* \* \*

Subjekti i romanit, në planin kohor, ngërthen dy linja kryesore: e sotmja dhe e kaluara. Nëse në planin e sotëm autori është qartësisht i përcaktuar, këtë gjë nuk mund ta themi për planin tjetër kohor, atë të së shkuarës ku Ballanca fokusohet në një interval më të gjerë, më gjithëpërfshirës, një të shkuar që rrok një periudhë e cila rrugëton në histori, duke nisur nga e kaluara e afërt (vitet e LANÇ) dhe duke depërtuar thellë në vitet e madje edhe shekujt. Përmes një shtrirjeje të tillë të subjektin dhe falë gjetjeve e detajeve tepër të goditura (subjekteve, rrëfimitarëve anonimë, kapitujve “Secili tregon një histori” zhvendosjeve në kohë dhe hapësirë, personazhit të veçantë të Bendos) Ballanca i ka dhënë veprës një karakter universal, sidomos në planin e idesë dhe mesazheve që përcjell. Ngjarjet e romanit, siç e thamë dhe më sipër, zhvillohen në një fshat të jugut ku jeton një komunitet, jeta e të cilit mbështetet në aktivitetin bujqësor dhe blegtoral. Në

<sup>7</sup> Gazeta “Drita” Tiranë, 19 gusht 1990, f. 6.

rrjedhën e ngjarjeve njihemi me mjaft anëtarë të këtij komuniteti, përfaqësues grupesh e moshash të ndryshme, të tillë si Bardha, Ndoni i vogël, xha Golja, Ndreku, Peçua, Myrtua, Hiqmeti, Cetka, Didikua, por dhe Sabri hoxha, Vasili, Elitani, Stefani, Hanko Nixhoja, Bendua, etj. Në këtë mori personazhesh të ndryshëm, në moshë, gjini e profesione, ndeshim dhe një dallim tjetër: një pjesë e tyre i përkasin së sotmes, një pjesë të shkuarës dhe një pjesë të dy kohëve, si ato urat që i kanë këmbët në dy brigjet (të së djeshmes dhe të sotmes). Mes këtij grupimi të tretë, një vend të veçantë zë për mendimin tonë personazhi i Bendos, i cili jetonte të djeshmen, jeton të tashmen dhe ëndërron e përpiqet të jetojë edhe të ardhmen. Bendua na paraqitet si një ish-ushtar i huaj mbetur në këtë fshat pas luftës dhe që jeton e punon mes një kolektivi blegtorësh e, ndërkohë, përpiqet të krijojë familjen e tij. Ajo që ngacmon dhe mban në tension kureshtjen e lexuesit gjatë gjithë veprës është se askush nuk e di dhe as arrin ta mësojë saktësisht origjinën e këtij njeriu dhe pse fshati nuk i jep nuse, fakte që sipas nesh përbëjnë një vlerë të padiskutueshme të subjektit. Ato nuk janë trajtuar apo dhënë nga autori si enigma intriguese për të mbajtur ngritur kureshtjen apo për të provuar aftësitë zbuluese të lexuesve. Synimi dhe, në funksion të tij, loja me këto fakte, bëjnë që ato të shndërrohen nga një gjëagjzë argëtuese në një mesazh të fuqishëm.

Bendoja nuk është vetëm një ushtar i panjohur apo një ushtar rob që ka humbur kujtesën e ka pëlqyer e zgjedhur të jetojë këtu, në një mjedis e komunitet të caktuar. Ai është shumë më tepër se aq edhe pse, në momente e rrethana të caktuara, sikur “nuk ta mbush mendjen”. Mbartës dhe shprehës i një sërë cilësish, shpesh të çuditshme madje dhe kontradiktore, ky personazh ndërthet në vetvete një tip me përmbajtje universale gjithashtu.

\* \* \*

Duke u kthyer sërish në subjektin e veprës, vëmë re se krahas linjës së Bendos, paralelisht kemi dhe zhvillimin e dy linjave të tjera: asaj të jetës dhe punës së komunitetit ku, natyrisht, përfshihet dhe kolektivi i barinjve, si dhe linjën tjetër ku nuk veprojnë personazhe bashkëkohës por na ofrohet një zinxhir historik e ngjarjesh të rrëfyera nga personazhe, më së shumti anonimë që, si në tërësinë ashtu dhe në veçantinë e tyre, nuk mbeten jetimë. Këto rrëfime, sa janë kujtime e jehonë e së shkuarës në funksion të së tashmes, po aq janë dhe një përvojë e mësim për të ardhmen. janë dëshmi dhe akuza, pësime dhe mësim, janë informacione për ngjarje të caktuara që përcjellin njëkohësisht debat dhe emocione. Me një rrëfim të tillë, ku përshkruhet historia e vrasjes së një djali të fshatit nga trupat pushtuese, nis dhe vetë romani.

Ky është, në formë tejet të ngjeshur, sfondi subjektor i romanit të Ballancës, ku e reja dhe e veçanta janë pikërisht historitë e ndërfutura me një

natyrshmëri dhe elegancë të admirueshme e gjithmonë në funksion të linjës kryesore të subjektit. Lëvizin para lexuesit, ashtu si në dublat e një filmi, njëra pas tjetrës, ngjarje nga e tashmja dhe e kaluara, të jetuara apo të rrëfyera. Në pamje të parë duken si episode të veçuara por, në tërësinë dhe ndërveprimin e tyre, përbëjnë një unitet duke qenë, jo vetëm në funksion të njëra tjetrës por dhe të idesë qendrore të veprës. Padyshim, këto tre linja kryesore të subjektit, brenda të cilit nuk mungojnë dhe episode, ngjarje, kujtime më pak të spikatura, por të domosdoshme, janë lidhur e vendosur nga autori në një mënyrë të caktuar, me synim kryesor ngritjen e ndërtesës artistike. Ky proces i rëndësishëm ka nisur që me përzgjedhjen e materialit jetësor, duke i paraprirë momentit më të spikatur të procesit krijues, atij të ngjizjes artistike të këtij materiali dhe kthimit të tij në një masë kompakte e unike. Sigurisht në këtë pikë shfaqet dhe arti, talenti dhe mjeshtëria e autorit.

\* \* \*

Është fjala për strukturën kompozicionale të veprës së Ballancës të cilën, po ta krahasojmë me një ndërtesë dykatëshe, çdo kat i saj do të përfaqësonte një pjesë të veprës, e cila përbëhet edhe ajo nga ty pjesë. Dy pjesë me dy tituj të ndryshëm, me përmbajtje të ndryshme që, megjithatë, janë në të tillë lidhje sa që mbeten si “kate të së njëjtës ndërtesë”.

Reja, që (“Re në sytë e një adoleshenti” - titulli i pjesës së parë) ka turbulluar dhe pengon shikimin e personazhit më të vogël të romanit, Ndonit, dalëngadalë shpërndahet, duke zbuluar “dritën” e enigmës (“Enigma zbulohet pa bujë” - titulli i pjesës së dytë dhe finalja e romanit) që na shoqëron gjatë gjithë veprës:

- Kush është Bendoja në të vërtetë?!
- Pse nuk i jep fshati nuse Bendor?!

Nëse gjithçka do të kufizohej brenda një konceptimi e realizimi të tillë të subjektit, pra thurjes së një enigme dhe përpjekjeve për ta zbuluar atë, nëpërmjet mendjes dhe botës së një fëmije (edhe pse një mjet tepër i goditur dhe i kërkuar me një intuitë të rrallë artistike) sigurisht që ne do të ishim më të kursyer në fjalët dhe pohimet tona. Këtu spikat edhe një cilësi tjetër e shkrimtarit që lidhet me aftësinë e tij për të gjetur dhe kthyer ngjarjet, në pamje të parë të rëndomta, në vlera të mirëfillta artistike dhe estetike. Është madje veçori dalluese e stilit të Ballancës zbulimi i vlerave të mëdha tek ndodhitë e vogla e të zakonshme. Por, këtu fillon dhe befasia. “Nomeja e largët” nuk është kronikë apo përshkrim i një ngjarjeje të rëndomtë, apo ndodhie “të vogël” nga rutina e jetës së përditshme. Pa rënë në grackën e ritregimit të fabulës, do na pëlqente të ndaleshim te një fakt, jo pa rëndësi; është fakti kryesor, bërthama rreth së cilës vërtiten gjithë ngjarjet që përbëjnë subjektin e romanit. Madje do

të na pëlqente ta quanim themelin mbi të cilin ngrihet solide gjithë struktura e veprës.

Një ushtar i huaj ka mbetur diku në një fshat në jug të Shqipërisë. Rob luftime, peng, me dëshirën e tij? Këto pyetje dhe të tjera që mund të shkojnë nëpër mend, të çojnë drejt linjës së enigmës që është e pranishme gjatë gjithë ngjarjeve të romanit. Por ky fakt evoluon më tej. Ushtari në fjalë, pikërisht në këtë vend, përpiqet të hedhë rrënjë me çdo kusht, përpiqet të krijojë familjen dhe të ardhmen e tij. Mirëpo dëshira dhe përpjekjet nuk ia mundësojnë realizimin e këtij synimi. Ato sfumohen, shëmben, shkatërrohen përpara të mundurës së pamundur. Sigurisht ka një absurd kuptimor në këtë pohim, por po aq ka dhe një të vërtetë të madhe. Është një e vërtetë që secili përpiqet ta pronësojë sipas konceptit të tij: Bëndua kërkon shoqen e jetës nga gjiri i komunitetit ku jeton e punon por, edhe komuniteti përpiqet në sens të kundërt duke mos dashur dhe duke mos ia ofruar këtë mundësi. Pikërisht në këtë çështje e mundura bëhet e pamundur edhe duke qenë realisht e mundur.

Parë në një tjetër këndvështrim, e drejta e Bëndos për tu martuar, tjetërsohet, duke u kthyer në të kundërt. E mundura për të nuk shkon dot më tej, ajo edhe pse një e drejtë universale, mbetet e tillë vetëm brenda dëshirave dhe përpjekjeve të tij. Ajo bëhet e vështirë dhe absolutisht e pamundur, duke qenë po aq e drejtë dhe e motivuar në një tjetër gjykim. Dhe, në këtë drejtësi të dyzuar, lëviz Bendoja me identitetin e tij po aq të dyzuar, i njohur dhe i panjohur. Një anormalitet brenda normalitetit të jetës së përditshme, brenda rrjedhës së zakonshme të saj.

Të gjitha këto e largojnë shumë këtë vepër të Ballancës (dhe novelën që i paraprin) nga tregimet dhe novelat e tjera të tij. Ajo nuk ngjan aspak qoftë dhe me njërin prej tyre. Megjithatë, mjeshtri Ballanca, edhe në “pazakonshmërinë” e ngjarjeve të këtij romani ia ka arritur të zbulojë të zakonshmen dhe veç kësaj, t’i japë asaj një karakter universal. Pikërisht është struktura kompozicionale e zgjedhur nga autori ajo që ia ka mundësuar këtë synim.

\* \* \*

Duke i bërë “autopsinë” romanit të Ballancës, jo vetëm në planin makro por dhe në atë mikro, do të arrinim të zbulonim vlerat “arkitekturore” të tij. Vetë termi arkitekturë, përdorur këtu më shumë në aspektin simbolik, ndër të tjera, të sjell ndërmend elementin hapësirë. Në këtë kontekst tek vepra e Ballancës dallojmë dy plane hapësinorë, të ndryshëm por dhe të lidhur e kushtëzuar nga njëri-tjetri. Është fjala për planet ku janë vendosur ngjarjet e romanit: fshati dhe stanet. Autori nëpërmjet alternimit të këtyre dy hapësirave, duke i zhvendosur ngjarjet nga fshati në stane dhe anasjelltas, bën të mundur përfitim të sfondit të plotë të shtjellimit të subjektit. Sigurisht brenda këtij

sfondi lëvizin njerëzit, personazhet aktorë të ngjarjeve të cilat kurrsesi nuk mund të perceptohen pa ata, pasivë apo aktivë qofshin. Përmes këtij elementi, shkrimtari realizon një tjetër plan të dyfishtë në sensin kohor (e shkuara dhe e tashmja).

Ndryshe nga plani hapësinor dhe lëvizja nëpër të, e cila kufizohet vetëm në dy mjedise (fshat dhe stan), në planin kohor, kjo lëvizje njih një kapërcim të kufinjve, sidomos në drejtim të së shkuarës. Në këtë element autori na ofron një shtrirje dhe lëvizje në thellësi, duke operuar me ngjarje që nisin nga lashtësia dhe vijnë në mënyrë graduale deri në ditët tona. Depërtimi në kohë, në kërkim të ngjarjeve që, së bashku duken si një udhëtim në historinë e popullit tonë (edhe pse të kufizuara në një trevë të caktuar) përbën padyshim një vlerë tjetër të veprës. Brenda këtij kuadri makro apo, siç u shprehëm më sipër, kësaj arkitekture makro, janë ideuar e ndërtauar me kujdes mjediset mikro, ku nisin e zhvillohen ngjarje të jetës së përditshme të cilat autori nuk i sjell thjesht si elemente ornamentale pasive por as dhe si përshkrime interieresh apo eksterieresh, të ngarkuara me një denduri fjalësh e shprehjesh të tepërta që do të zvarrisnin ecurinë e ngjarjeve. Një pohim i tillë nuk do të thotë se autori është i varfër apo bujar dhe dorëlëshuar në përdorimin e fjalëve. Përkundrazi, ai është tepër racional dhe mjetet leksikore, që ka në dispozicion, i përdor mjeshtërisht në vendin dhe kohën e duhur.

Duke u larguar nga konsiderimi dhe analiza e mjeteve të zgjedhura e përdorura nga autori në planin stilistik dhe duke vazhduar përsëri me strukturën kompozicionale të romanit ku spikat dhe e veçanta e veprës së Ballancës, do të qe më me interes evidentimi i kësaj strukture në planin e ndërtimit të personazheve. Është edhe ky një element ku vepra shfaq vlerat apo cilësitë ndryshe të saj. Nuk do ta mendonim si rastësi por si një gjetje apo veprim të mirëmenduar të autorit, praninë në roman të një numri jo të vogël personazhesh dhe, veçanërisht, larminë e tyre. Në këtë cilësi të dytë, me pak kujdes, do të dallonim një dukuri specifike: në numrin jo të vogël të personazheve, do të gjenim për secilin prej tyre, apo për secilin grup personazhesh, antipodin e tij. Nëse do të bënim një paraqitje grafike do të përftonim çifte të tilla si: realë-anonimë, të gjallë-të vdekur, individë-kolektiv, vendas-të huaj, të rinj-të moshuar, femra-meshkuj, veriorë-jugorë, fshatarë-qytetarë, pozitivë-negativë. Një konceptim i tillë i personazheve (përfaqësues karakteresh të ndryshëm) i ka dhënë të tjera dimensione dhe një shtrirje e frymëmarrje më të gjerë veprës, duke ndihmuar edhe autorin në konkretizimin më të plotë të synimeve të tij ideoartistike. Brenda ngjarjes kryesore, historisë së çuditshme të Bendos dhe dramës së tij tragjikomike, çdo element tjetër i qëmtuar dhe shfrytëzuar nga autori, mjedis, episod a personazh qoftë, vjen si

domosdoshmëri logjike e artistike njëkohësisht, është si një tullë në një mur, lëvizja apo heqja e së cilës mund të sjellë rrëzimin gradual të murit.

Në dialektikën e tyre, kurrsesi nuk mund ta kuptojmë apo analizojmë Bendon jashtë kolektivit të barinjve, stanin pa fshatin, të tashmen pa të shkuarën, pleqtë pa të rinjtë, fshatarët e jugut pa vëllezërit e tyre veriorë.

\* \* \*

Dy pjesët e romanit kanë thujse numër të barabartë kapitujsh (nga 15). Por, krahas këtyre ndarjeve dhe një emërtimi të tillë, Ballanca ka futur në roman dhe një numër ndarjesh të tjera (10) të cilat ai nuk i emërton kapituj por “Gjithsecili tregon një histori”. Jo vetëm emërtimi i tyre, që është i ndryshëm, por dhe vendosja në vepër është bërë në atë formë që i jep romanit pamjen e një mozaiku, dukuri kjo e pohuar edhe nga kritika. Në çdo tre kapituj autori ka futur një histori të tillë. Kjo gjetje e shkrimtarit nuk është thjesht një element ornamental. Përkundrazi, për mendimin tonë, futja e këtyre historive në intervale kohore të caktuara që, për të qenë më të saktë do t’i quanim ndalesa në ecurinë dhe zhvillimin e ngjarjeve është, bashkë me figurën e Bendos, gjetja më origjinale dhe elementi më me vlerë në kuadrin e karakterizimit të romanit si një roman ndryshe.

Asnjë nga historitë e ndërfitura nuk është ngjarje e tipit retrospektiv dhe as nuk kryen atë funksion e, pikërisht këtu evidentohet edhe një element tjetër “ndryshe”. Po aq “ndryshe” na paraqitet edhe figura e Bendos e linja që lidhet me të. Pa hyrë në një analizë të detajuar të veprës, por thjesht në një lexim vertikal të saj, të krijohet përshtypja se Bendua është njëri prej personazheve të rëndësishëm të romanit. Madje, pa e vendosur në kuadrin e kriterëve (ideore dhe artistike), që do t’ia jepnin realisht këtë pozicion, lexuesi i zakonshëm do të fliste me bindje për këtë personazh kryesor. Por, për arsye të ndryshme që, në fund të fundit, janë edhe këto zgjedhje origjinale të autorit, Bendua është një nga personazhet kryesorë dhe jo i vetmi.

Origjinaliteti qëndron në faktin se autori e ka parë si më të arsyeshme “gjithmonë në funksion të veprës dhe idesë”, mbështetjen jo tek një por tek tre personazhe kryesore, katërcipërisht të ndryshëm nga njëri tjetri. Në një vështrim të përgjithshëm ke bindjen se asgjë nuk mund t’i lidhë, afrojë e bashkojë këta tre personazhe. Madje dy prej tyre nuk të japin përshtypjen se mund ta mbajnë një “barrë” të tillë. Përballë apo pranë Bendos, do të ndodhet Ndoni (një fëmijë) dhe kolektivi i barinjve me të cilët punon Bendua. Në jo pak raste këto personazhe i gjejmë edhe të dy njëkohësisht pranë tij. Të dy ata, në mënyrën e tyre, na afrojnë përherë e më shumë tek “enigma” Bendo. Nga njëra anë kureshtja prej adoleshenti e Ndonit të vogël dhe, nga ana tjetër, bisedat, qëndrimet, raportet dhe marrëdhëniet, herë pozitive e herë negative të kolektivit të barinjve ndaj Bendos, ushqejnë dhe mbajnë gjallë tensionin

dramatik të veprës por edhe interesimin dhe vëmendjen e lexuesit deri në fund të romanit. Nuk themi ndonjë gjë të re nëse pohojmë se, pikërisht në rreshtat e fundit të veprës, mësojmë përfundimisht rreth “të panjohurit” Bendo dhe atë ç’ka ai përfaqëson. Megjithatë, edhe në këtë aspekt, shkrimtari është kujdesur dhe thujse ia ka arritur plotësisht të mënjanojë “Bendomaninë” pasi synimi i tij nuk është ky ish-pushtues, pa identitet e pa të shkuar. Por, përmes këtij personazhi-simbol zbulohet psikologjia, natyra e vërtetë, synimi gjithmonë kriminal i pushtuesve, edhe pse i fshehur pas pamjeve dhe sjelljeve tragjikomike. Pranëvënia e Bendos me barinj të tjerë, me banorët e fshatit, me Ndonin e vogël dhe jetët e tyre (ekstremisht të ndryshme nga jeta e tij) është një pohim i fuqishëm i jetës së shqiptarëve, me problemet, hallet, gëzimet dhe ëndrrat e tyre, ëndrra që i kanë rrënjët te sakrificat e vuajtjet shekullore, të cilat nuk mund të lejojnë dhe pranojnë bashkëjetesën me ish-vrasësit dhe shkatërruesit e jetëve të tyre. Këtë jetë të re dhe të bukur të njerëzve tonë (barinj, bujq, punëtorë a intelektualë qofshin, të rinj apo të moshuar, burra apo gra) e gjejmë gati në çdo faqe të romanit, jo vetëm si një realitet të ri dhe antipod të së kaluarës tragjike por dhe si bartëse e një mesazhi të fuqishëm të cilin do ta shprehim duke perfrazuar një studiues të veprës së Ballancës, Edor Gjergon i cili thotë se “...ajo (jeta - shënimi im) vazhdon rrjedhën e saj të gëzuar dhe, një a më shumë Bendo (megjithëse nuk mund dhe nuk duhen harruar) nuk janë në gjendje ta turbullojnë”.<sup>8</sup>

\* \* \*

Në vazhdim mendojmë se ia vlen të qëndrojmë disi më gjatë te personazhi i Bendos që sipas nesh përbën një figurë të rrallë dhe të panjohur deri më sot në letrat shqipe. Para se ta analizojmë dhe vlerësojmë këtë personazh le të marrim në konsideratë karakterizimin që i ka bërë kësaj figure një mjeshër tjetër i letrave shqipe, Teodor Laço. Duke u shprehur për të ai thotë: “Komplekse figura e Bendos si dhe qëndrimi ndaj tij. Ai është vërtetë viktimë por nga ato viktima që s’janë aq të pafajshme sa mund të mendohet, sepse ruajnë vazhdimisht diçka të errët në subkoshiençë, diçka makabre, një rrezik potencial që është i verbër sepse s’di të bëjë dallime”<sup>9</sup>.

Një analizë e kujdesshme e këtij personazhi na zbulon një karakter ku ndërthuren, në një mënyrë të natyrshme e të çuditshme cilësi të rralla por dhe tepër domethënëse psikofizike që e bëjnë vërtetë të veçantë këtë figurë në letërsinë tonë. Por, lexuesi nuk krijon këtë përshtypje teksa shfleton faqet e para të romanit. prezantimi me Bendon të njeh me një burrë rreth të dyzetave,

<sup>8</sup> Edor Gjergo, “Nëntori”, 1990/6, f. 71-76.

<sup>9</sup> T. Laço, “Drita”, Tiranë 19 gusht 1990, f. 6.

njeri përgjithësisht i qetë, madje të heshtur e të përkushtuar në punën e tij të përditshme të bariut dhe që përpiquej të shkrihej natyrshëm me njerëzit në përgjithësi dhe shokët e punës së tij barinj, në veçanti. Parë në këtë plan dhe këndvështrim, personazhi i Bendos kalon pa të shkaktuar ndonjë ndjesi të veçantë, madje vështirë të krijosh bindje se ke përpara një nga protagonistët e veprës i cili është nyja organizuese e gjithë subjektit të romanit. Por, leximi i mëtejshëm i veprës, njohja me rrjedhën e ngjarjeve, na përball me një tjetër Bendo, jo në aparencë, në veshje apo mënyrën e të punuarit. Një dallim në këto aspekte është më se logjik, por, duke vrojtuar më me kujdes disa sjellje dhe veprime të tij në dukje të rëndomta, ne çuditemi dhe befasohemi. Këtë befasim nuk na e shkaktojnë as trupi i dobët dhe mprehtësia e fytyrës, as hunda e madhe dhe pak e kërrusur, as flokët e rrallë dhe të butë, as këmisha e hollë apo pantallonat e tij të gjëra. Janë të tjera elemente dhe detaje që autori i ka shfrytëzuar mjeshtërisht duke na sjellë një Bendo të ndryshëm, të veçantë, të çuditshëm dhe befasues. Nga njëri episod tek tjetri ne ndeshemi me një njeri të shushatur, të vetmuar (njeri pa njeri në botë), të ndrojtur nga vajzat (por dhe të etur për t'u lidhur e martuar), të tërhequr nga jeta shoqërore, një ish ushtar të huaj pa identitet, një mashkull të aftë biologjikisht, një viktimë të Luftës, një individualist, thënë me pak fjalë një krijesë reale pavarësisht karakterit tejet kompleks të saj, që lufton për mbijetesë dhe jo vetëm, diku në një fshat në jug të Shqipërisë. Karakteri i tij i çuditshëm shfaqet dhe spikat edhe më shumë në një sërë sjelljesh të tij, ku ka diçka që nuk shkon, diçka që në tërësinë e saj, bart enigmën, absurdin, dredhinë, urrejtjen, objektiven dhe subjektiven, realen dhe mitiken, zotësinë dhe pazotësinë, fajtorin dhe viktimën. Të gjitha këto cilësi janë ana tjetër e medaljes Bendo, që e sfumojnë jo pak atë anë të cilën do ta quanim Bendon e zakonshëm, të ngjashëm më çdo njeri tjetër.

Mendojmë se, jo vetëm zotërimi i të tilla cilësive por dhe mënyra e shprehjes së tyre në jetën e përditshme si dhe paraqitja e jashtme e Bendos, nuk lenë shteg mëdyshjeje apo kundërshtimi ndaj mendimit zotërues të kritikës sipas të cilit Bendoja, më shumë se real, është një personazh simbol. Cilësi të lindura (i huaj), të formuara dhe të kultivuara (pushtues) apo të fituara e të ngulitura (si rezultat i rrethanave në të cilat u gjend në kohë dhe vende të caktuara), ndërthuren me njëra-tjetrën në mënyrë të përsosur, edhe pse në mjaft raste janë në kundërshti të theksuar dhe potencialisht të papajtueshme.

Bendua ka një identitet të njohur por dhe të panjohur, kërkon të jetojë normalisht por nuk mundet, ka ëndrra dhe dëshira të cilat nuk i realizon dot dhe kjo i shkakton dramën e tij e cila na shfaqet si një situatë sa tragjike aq dhe komike. Ai është një viktimë e fajshme e luftës (si pushtues) por dhe “e pafajshme” e mëshirueshme e ndërkohë e urreyer. Nuk është vetëm kjo ekzistencë e dyfishtë dhe në ndonjë rast e trefishtë ajo që e bën më të

ndërlikuar figurën e Bendos. Ai është njëkohësisht një qenie enigmë jo vetëm për Ndonin e vogël por edhe për lexuesin.

Në përditshmërinë e tij Bendua, përtej një sfondi në dukje përgjithësisht të qetë, na ofron edhe një lloj konfliktualiteti përsëri të çuditshëm, por edhe këtë të dyzuar. Këtë konfliktualitet ai e ka me shokët e punës dhe komunitetin, por dhe me veten e tij. Ky konfliktualitet rrjedh si pasojë e të jetuarit në dy realitete: realiteti objektiv të cilin e jetojnë të gjithë të tjerët, por dhe një realitet subjektiv që e ka krijuar Bendua vetë. Ky realitet i dytë nuk lidhet me fshehjen e Bendos pas së shkuarës së tij (sepse ai nuk njihet dhe as ka një të tillë) por me përpjekjet për të jetuar normalisht të tashmen dhe për të ndërtuar të ardhmen e tij. Në këtë vorbull trikohëshe ai lufton në kërkim të asaj që nuk e di por dhe të asaj që nuk ka, ndaj krijon realitete subjektive, herë si ëndrra dhe herë si mite. Këtu shfaqet fuqishëm dhe konflikti i tij me vetveten që dalëngadalë kthehet në një dramë vuajtjesh të padurueshme ku personazhi Bendo përplasat jo vetëm me pamundësinë e krijimit të familjes, por dhe me ftohtësinë, indiferentizmin dhe urrejtjen e një komuniteti të tërë, të cilat ai nuk di as t'i motivojë e as t'i shpjegojë, gjë që sjell dhe veprime të pakuptimta e të çuditshme, jo logjike, herë-herë qesharake, por edhe të rrezikshme.

Bota e tij nuk është vetëm bota e një njeriu të shushatur e të vetmuar që të shkakton dhimbje e mëshirë, as e një krijese të cilës “padrejtësisht” i mohojnë një të drejtë njerëzore, krijimin e familjes dhe vazhdimësinë e saj. Ajo është bota e një viktime të fajshme, e një ish-pushtuesi, e një njeriu pa kujtesë që, folenë e tij, kërkon ta ngrejë mes një komuniteti me kujtesë, me të shkuar, të tashme dhe të ardhme. Është bota e një njeriu që urren jo pak, që aq sa dukej, siç thotë autori, “...si i hutuar, si i rrahur”<sup>10</sup>, si një njeri fatkeq, i humbur e i pashpresë, po aq ishte bartës i një rreziku të vogël dhe përherë të mundshëm. Në kuadër të këtij rreziku Bendoja ishte gati të bënte edhe të pamundurën të mundur, madje të rrëmbente e të zhdukte dhe vetë hënën!! “Hëna ndriçonte lart në mal dhe Bendua ngjitej sikur donte ta kapte hënën e ta shtrëngonte në gjoks. Ishte natë e thellë. Askush nuk do ta shihte. Do ta rrëmbente si lëmsh drite dhe barinjte do të humbisnin e nuk do t'i gjenin më shtigjet në errësirë”<sup>11</sup>.

Në këtë ëndërr të tij ka më shumë se urrejtje, një urrejtje që edhe pse naive, është jehonë e origjinës dhe së shkuarës së Bendos e dëshmi e rrezikshmërisë së përjetshme të armikut, përfaqësues i të cilit ai ishte.

<sup>10</sup> F. Ballanca, “Nomeja e largët” f. 67.

<sup>11</sup> F. Ballanca, po aty, f. 68.

\* \* \*

Në këtë këndvështrim Bendua është një konvencion, një simbol, madje tejet original dhe i realizuar mjeshtërisht nga shkrimtari. Edhe ky është pa asnjë diskutim një element, madje më i gjeturi e më i godituri në kuadrin e romanit “ndryshe”. Edhe pse autori i ka vënë një emër (një konvencion brenda konvencionit), pa hezitim mund të themi se ai, edhe duke qenë anonim, përsëri do ta realizonte po aq mirë funksionin për të cilin e ka krijuar shkrimtari. Mund të ishte turk, grek, po aq sa dhe italian apo gjerman. Çfarëdo që të qe, në thelbin e tij, ai mbetet një pushtues dhe asgjë më tepër dhe, në këtë aspekt Bendua është një personazh simbol. E reja që e dallon është se ai është konceptuar në dy plane: si personazh simbol dhe si personazh real por që asnjëri nuk përjashton tjetrin. Autori ka ditur të gjejë jo pak “ura lidhëse” të cilat mundësojnë bashkëjetesën e këtyre dy personazheve, pa cënuar njëri-tjetrin.

Lexuesi, po aq sa nuk e njeh Bendon, aq edhe e njeh, po aq sa nuk e beson dhe është në kërkim të identitetit të tij “të fshehur”, aq dhe zbulon elemente dhe vakte nga ky identitet, duke u afruar përherë e më shumë me atë çka ai “fsheh” por edhe përfaqëson.

Sigurisht, Bendua i djeshëm nuk është çobani Bendo i sotshëm por ky i fundit, edhe pse i tillë, nëpërmjet shumë sjelljeve dhe veprimeve, na çon tek Bendua i djeshëm që nuk ndryshon shumë në thelb nga Latrani, nga ushtarët që lidhën e dhunuan Sabri Hoxhën, nga italianët apo gjermanët që bënë masakra në jug a veri dhe që ishin po aq të këqinj, dinakë, mashtrues dhe hakmarrës sa edhe ai.

Nëse të gjithë këta i prunë, në kohëra të ndryshme, për të mbjellë vdekjen trojeve tona, shumë prej tyre e paguan këtë ardhje duke lënë kockat këtu. Por, një pjesë edhe mbeti, jo vetëm si një relikë e një lavdie të dështuar e të mbuluar me turp, por dhe si një vemje që përpiqet të gjejë apo krijojë (sa të mundet) kushtet për të mbijetuar dhe, më pas...pse jo, edhe për të rifituar lavdinë e humbur.

Falë kësaj figure, por jo të ndarë nga figurat e tjera jo më pak simbolike e përfaqësuese dhe të përfshira brenda një subjekti, që është produkt edhe i një strukture të veçantë kompozicionale, romani i Ballancës na ofron vërtet një model të ri, të ndryshëm dhe në funksion të plotë me mesazhin që autori do të përcjellë. Simbolikën e veprës të cilën e shpreh kryesisht figura e Bendos, e plotësojnë dhe e nxjerrin më në pah edhe personazhe të tjerë simbol, si: Bardha me cenin e saj fizik, Ndoni i vogël me kureshtjen e tij të theksuar, kolektivi dashamirës, mëshirues por edhe konfliktual me Bendon, fshatarët nga veriu, por edhe “historitë e ndërfutura”.

Në një tjetër këndvështrim, i cili nuk kishte pse të na çonte tek mendimi i një romani “ndryshe”, do të kishim modele të lexueshme apo të

konsumuara (për shumë arsye), nuk kishte pse të mbahej një Bendo anonim (dikur ushtar pushtues dhe tani bari në një fshat të jugut), një rob i pariatdhesuar apo dorëzuar tek autoritetet, nën “urrejtjen” por edhe në miqësinë e mëshirën e banorëve të Lugut, me synimin për tu bërë banor dhe familjar i natyrshëm i fshatit. Nuk kishte përse t’i refuzohej çdo vajzë e fshatit, nuk kishte përse të futeshin ngjarje e histori autorësh anonimë që lidheshin më të kaluarën e rëndë dhe luftën e vështirë zhvilluar atyre anëve, nuk kishte përse të futej në lojë një fëmijë, për të zbuluar një enigmë tepër “enigmatike”, etj. Falë gjithë këtyre detajeve të zgjedhura apo ndërtruara me kujdes dhe me një funksion të qartë vepra e Ballancës e ruan dhe e shpreh më së miri konceptimin e saj simbolik. Në këtë pikë do të bashkoheshim me një tjetër mendim të shprehur nga studiues dhe kritikë të ndryshëm sipas të cilëve, e gjithë “materia” e kësaj vepre bart karakterin universal në gjithë elementët përbërës kryesorë të saj: të jetës së pasqyruar, të problematikës, të ekzistencës njerëzore, të unitetit njeri-tokë-naturë, etj.

Duke cituar përsëri Teodor Laçon, do të ritheksonim forcën, origjinalitetin, karakterin universal të këndvështrimit e trajtimit të ngjarjeve e personazheve, atë që ne pëlqyem ta quajmë roman “ndryshe”: “Ajo që e ka ruajtur veprën të freskët është se jeta dhe koha, problemet e individit dhe shoqërisë janë parë në një thelb universal: njeriu dhe kujtesa e tij historike, njeriu dhe vendlindja e kuptuar kjo si prag i atdheut, fshatari dhe marrëdhëniet e tij të përjetshme me tokën dhe bagëtinë, uniteti shpirtëror me punën dhe natyrën, dy burimet e gjithë të mirave materiale që synojnë vazhdimësinë e jetës...”<sup>12</sup>

Sigurisht, ky karakter universal do të qe fallco, i pabazë dhe jorealit nëse do të konceptohej apo mendohej pa të shkuarën, atë faktor vendimtar dhe përcaktues për çdo popull që kërkon të ndërtojë të ardhmen e tij.

## SUMMARY

### AN ORIGINAL GLANCE OF THE WAR OF OUR PEOPLE (NOVEL “NOMEJA E LARGËT” OF FAIK BALLANCA)

In this article is done the attempt to argue why this work of Faik Ballanca is a novel that differs from all kinds of novels, not only of this author (who hasn't written another novel) but and other novelists, too.

<sup>12</sup> T. Laço, Drita, 19 gusht 1990, f. 6.

Faik Ballanca, the author of this novel, titled “Nomeja e largët”, except this, wrote also many books of short stories. Two are the themes that interest this writer in his creations:

1. Contemporary albanian man (in ethic and moral view)
2. Albanians in history. In this novel we can say that these themes are smelt in one, although the aim of the author is to write a work which is connected with the war of albanians against the enemies (occupators) but not special ones.

That’s why he brings in his novel a specific character like Bendo who is a conqueror, without a real name, without his native origin foreign, a little strange in his behaviours and relations with the people round him. This is one element that makes this novel different. But the work shows a number of other characteristics that give us the right to classify it as a novel “diversely” like, the special subject of it, the action which is developed in two times (past and present), the fact that in the village where the events happen, have passed many conquers during the times, the contradictional position of peasants and shepherds with whom Bendo lives and works. They love and hate him in the same time. (they love as a man and hate as an enemy). Another special element is connected with the composition of this novel. The author, except the main subject, constructs and puts among the chapters of his novel many stories, chiefly of the past, which present events from many years ago and make known the efforts of the people for freedom. These stories which are told from different inhabitants of the village, in one way, realize the join of the past and the present, underlining the strong desire and love of our people to live free. Another characteristic of the novel is that it doesn’t describe or gets on only with the war of our people but shows the today’s life, too. All the events happen in a village in south Albania, among the peasants of it and especially among a collective of shepherds.

Naturally, there are also other elements except these, which we brought here, that make this work of Ballanca a special one and that are expressed in details in this article.